



3

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr. 2773/11 Prot

Elbasan më 18/06/2020

VENDIM

Nr. 53 datë 18/06/2020.

**Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin MAJ 2020**

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, si dhe bazuar në kriteret e VKB nr 3 datë 27.01.2020 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë”

VENDOSI

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i të ardhurave të bashkisë për muajin MAJ 76 familje me fond 261.180 lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Kujdesit Social dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Sekretari i Këshillit Bashkiak  
Klajd Gripshi

Kryetari i Këshillit Bashkiak  
Hektor Çiftja





2

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr. 2742/11 Prot

Elbasan më 18/06/2020

VENDIM

Nr. 54 datë 18/06/2020

**Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin MAJ 2020**

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenin 21 të ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, si dhe bazuar në kriteret e VKB nr. 4 datë 27.01.2020 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike”

V E N D O S I

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e kushtëzuara për muajin MAJ 2020 gjithsej 103 familje me një fond prej 334.608 lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Sekretari i Këshillit Bashkiak  
Klajd Gripshi

Kryetari i Këshillit Bashkiak  
Hektor Çiftja







5

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2716/1 Prot.

Elbasan, më 18.06.2020

VENDIM

Nr. 55 datë 18.06.2020

***“Për një ndryshim në VKB nr. 179 datë 04.12.2019 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Elbasan, për vitin 2020”***

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Administrata dhe Kryetari i Bashkisë “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKB nr.179 datë 04.12.2019 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Elbasan, për vitin 2020”, bazuar në:

- Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar;
- Ligjin nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar;
- Ligjin nr.9920 datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligjin nr.9975 datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar;
- Ligjin nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;
- VKM nr.132 datë 07.3.2018 “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesë”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës”, i ndryshuar;
- Ligjin nr.15/2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, i ndryshuar;
- Urdhërin të MSHMS nr.132 datë 08.3.2020 “Për mbylljen e aktiviteteve publike dhe jopublike dhe anulimin e grumbullimeve masive në vende të mbyllura apo të hapura”, i ndryshuar;
- Urdhërin e MSHMS nr.156 datë 10.3.2020 “Për marrjen e masave të veçanta në parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”;
- Urdhërin e MSHMS nr.164 datë 12.3.2020 “Për mbylljen e bareve, restoranteve, lokaleve, fast food dhe kufizimin e shërbimeve që ofrohen nga strukturat akomoduese që ofrojnë shërbim për klientët”;
- Urdhërin e MSHMS nr.193 datë 20.3.2020 “Për mbylljen apo kufizimin e lëvizjeve në Republikën e Shqipërisë”;
- Udhëzimit të ISHP me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19;

VENDOSI:

1. Ndryshimin e pikave 1; 2 dhe 3 të tabelës “G” “Tarifa për zënien e hapësirave publike.” si më poshtë:

Nr.	Lloji i Tarifës	Niveli tregues Bashkia Elbasan Njësia
1.	Tarifa për zënien e hapësirës publike për tregti brenda Zonës A.	360 lekë/ m <sup>2</sup> / muaj
2.	Tarifa për zënien e hapësirës publike për tregti brenda Zonës B.	220 lekë/ m <sup>2</sup> / muaj
3.	Tarifa për zënien e hapësirës publike për tregti brenda Zonës C.	100 lekë/ m <sup>2</sup> / muaj

2. Shfuqizimin e pikës 7 të tabelës “G”.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari dhe Administrata e Bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**SEKRETARI**

**Klajd Gripshi**

**KRYETARI**

**Hektor Çiftja**







792  
18.06.2020



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr. 2774/11 Prot

Elbasan më 18/06/2020.

**VENDIM**

Nr. 56 datë 18/06/2020.

**Mbi miratimin e “Planit të Rishikuar të Mbrojtjes Sociale  
2020-2022 të Bashkisë Elbasan”.**

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës \_\_\_/06/2020 pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga DSHKSK, bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenin 24, 28/1 dhe ligjin nr. 121/2016 datë 24.11.2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqërorë” neni 36,

**VENDOSI**

1. Të miratojë “Planin e Rishikuar të Mbrojtjes Sociale 2020-2022 të Bashkisë Elbasan”.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social e Komunitar, Drejtoria e Buxhetit si dhe Drejtoria e Financës.
1. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas miratimit nga Këshilli Bashkiak.

Sekretar i Këshillit Bashkiak  
Klajd Gripshi

Kryetar i Këshillit Bashkiak  
Hektor Çiftja





793  
19.06.2020



4

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2719/11 Prot.

Elbasan më 18.06.2020

VENDIM M157 dt 18.06.2020

"KUFIZIMIN E QARKULLIMIT TË AUTOMJETEVE NË DY SEGMENTE TË  
BULEVARDIT AQIF PASHA"

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës 18.06.2020, pasi shqyrtoi materialin sektori i transportit në Drejtorinë e Shërbimit Territorit Urban "Për kufizimin e qarkullimit të automjeteve në dy segmente të bulevardit Aqif Pasha" me fasha orare, Mbështetur në ligjin 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; neni 7 germa b të ligjit nr.8378, datë 22.07.1998 "Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar; ligjin Nr. 8308, datë 18.3.1998 "Për transportet rrugore" të ndryshuar,

VENDOSI

Të miratoj:

1. "Kufizimin e qarkullimit të automjeteve në dy segmente të bulevardit "Aqif Pasha" me fasha orare sipas tabelës së mëposhtme me:

Nr.	Segmenti Rrugor	Për ditët	Pranverë Verë	Vjeshtë Dimër
1	Stadiumi - K.Kristoforidhi	Premte - Shtunë	19:00-22:00	18:00-21:00
2	K.Kristoforidhi - 1 Maji	Hënë - Dielë	19:00-22:00	18:00-21:00

2. Vendimet e mëparshme lidhur me kufizimet e qarkullimit në bulevardin "Aqif Pasha" të shfuqizohen.
3. Për ndjekjen dhe zbatimin këtij vendimi ngarkohet Drejtorinë e Shërbimit Territorit Urban dhe ASHP.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 dite pas shpalljes.

SEK. K. BASHKIAK

Klajdi Gripshi

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Hektor Ciftja





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2718/11 Prot.

Elbasan më 18.06.2020

V E N D I M

Nr. 58 Datë 18.06.2020

Për

**Shndërrimin e segmentit rrugor "Caush Asllani", (Nga kryqezimi i rruges "Aqif Pasha" me rrugen "Caush Asllani", ne Jug dhe i rruges "Tomor Domi" me rrugen "Caush Asllani", ne Veri), në rruge këmbësoresh dhe korsi bicikletash pjesa prane lulishtes, per pasoje ndalimin e qarkullimit dhe pushimit të mjeteve.**

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës \_\_.06.2020, pasi shqyrtoi materialin dhe propozimin e administratës së Bashkisë, "Për shndërrimin e segmentit rrugor "Caush Asllani", (Nga kryqezimi i rruges "Aqif Pasha" me rrugen "Caush Asllani" ne Jug dhe i rruges "Tomor Domi" me rrugen "Caush Asllani", ne Veri), në rruge këmbësoresh dhe korsi bicikletash pjesa prane lulishtes, per pasoje ndalimin e qarkullimit dhe pushimit të mjeteve". Bazuar në ligjin 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr. 8378, datë 22.7.1998, "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

V E N D O S I

1. Të miratoj shndërrimin e segmentit rrugor "Caush Asllani", (Nga kryqezimi i rruges "Aqif Pasha" me rrugen "Caush Asllani", ne Jug dhe i rruges "Tomor Domi" me rrugen "Caush Asllani", ne Veri), në rruge këmbësoresh dhe korsi bicikletash pjesa prane lulishtes, per pasoje ndalimin e qarkullimit dhe pushimit të mjeteve.
2. Ky vendim hyn ne fuqi 10 dite pas shpalljes.

SEK. K. BASHKIAK  
Klajdi Gripshi

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIA  
Hektor Çiftja







9

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2767 Prot.

Elbasan, më 18.06.2020

VENDIM

Nr. 58 Datë : 18.06.2020

**“Mbyllje procedure privatizimi banese shtetërore”**

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . \_\_\_\_ pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të të Ardhurave Aseteve, Buxhetit dhe Financës, (Sektori i Strehimit, Privatizimit), mbështetur në Ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Dekretin e Presidentit të Republikës Nr.1440 datë 04.04.1996 “Për trajtimin e banesave shtetërore të paprivatizuara”, Ligji Nr. 22/2018 “Për Strehim Social”, VKM nr.179 datë 26.02.2020 “Për rregullat, kushtet dhe procedurat e privatizimit të banesave që kanë qenë subjekt i ligjit nr.7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, dhe të ligjit nr.9321, datë 25.11.2004, “ Për privatizimin e banesave dhe objekteve të kthyer në banesa, të ndërtruara me fondet e shoqërive dhe ndërmarrjeve shtetërore”

**V E N D O S I :**

- 1) Miraton **“Mbyllje procedure privatizimi banese shtetërore”** për qytetarët e mëposhtëm:
  - **Qytetari Osman Elmaz Muça dhe personat e tjerë madhore sipas çertifikatës të gjëndjes familjare 01.12.1992**, për privatizimin e apartamentit të përbërë nga një dhomë dhe një kuzhinë, të ndodhur në lagjen “28 Nëntori”, pallatit 120, shkalla B, kati 5, apartamenti nr.14, zona kadastrale 8523, Elbasan.
  - **Qytetari Abaz Xhemo Mushi dhe personat e tjerë madhore sipas çertifikatës të gjëndjes familjare 01.12.1992** për privatizimin e apartamentit të përbërë nga një dhomë dhe një kuzhinë, të ndodhur në lagjen “Vullnetari”, Rruga “Pirro Shuteriqi”, pallatit 645/1, shkalla B, kati 4, zona kadastrale 8524, Elbasan.

5

Tarifat e pagesës së privatizimit do të bëhen në mbështetje të VKM nr.179 datë 26.02.2020.

- 2) Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të të Ardhurave Aseteve, Buxhetit dhe Financës, (Sektori i Strehimit, Privatizimit).
- 3) Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**SEKRETARI**

**Klajd GRIPSHI**



**KRYETARI**

**Hektor ÇIFTJA**



8

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN  
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 27457 Prot.

Datë 18 .06. 2020

**VENDIM**

NR. 60 DATË 18 .06. 2020

**MBI**

**"PËR MIRATIMIN E KRITEREVE DHE PËRCAKTIMIN E RRUGËVE DHE SHESHEVE PUBLIKE PËR ADMINISTRIMIN E SHËRBIMIT TË PARKIMIT ME PAGESË TË BASHKISË ELBASAN"**

Në mbështetje të dispozitave të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 8, pika 2, neni 9, pika 1.1 dhe pika 1.3(b), neni 23, pika 4, neni 32, pika 1, neni 33, pika 1/a dhe pika 2, neni 35, pika 5/a, neni 54, pika (f) dhe pika (k), të Ligjit Nr.8378, datë 22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", neni 7, pika 1(f) dhe pika 8, si dhe të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", neni 35, bazuar në propozimin e Drejtorisë së Shërbimit të Territorit Urban, Sektori i Transportit, në Bashkinë Elbasan, Këshilli i Bashkisë Elbasan, pasi vlerësoi domosdoshmërinë e ofrimit të shërbimit të parkimit me pagesë në rrugë dhe sheshe publike të qytetit Elbasan dhe shqyrtoi kriteret për realizimin e këtij shërbimi, në mbledhjen e tij të datës \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020,

**VENDOSI:**

1. Të miratohet shërbimi i parkimit me pagesë orare, në rrugë dhe sheshe publike të bashkisë Elbasan.
2. Shërbimi i parkimit me pagesë orare është shërbimi i ofruar për rregullimin e parkimit të automjeteve në qytet, ku qëndrimi i automjeteve kushtëzohet nga pagesa e një tarife (shume) që varet nga kohëzgjatja e qëndrimit në parkim.
3. Të miratohen zonat në rrugët dhe sheshet publike të Bashkisë Elbasan si dhe fashat orare ku do të realizohet shërbimi i parkimit me pagesë, sipas Tabelës nr.1 dhe (hartës) bashkëlidhur këtij vendimi.
4. Identifikimi i zonave të parkimit me pagesë në rruget dhe sheshet publike do të bëhet nëpërmjet vizimit me ngjyrë BLU dhe/ose tabelave vertikale sinjalizuese për zonën e destinuar për shërbimin e parkimit me pagesë.
5. Tarifa e shërbimit të parkimit me pagesë do të jetë ajo e pikës 1-1 tabela H e VKB-së Nr. 179 Datë 04.12.2019 "Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Elbasan për vitin 2020" për miratimin e taksave dhe tarifave vendore
6. Administrimi i shërbimit të parkimit me pagesë të kryhet drejtpërdrejt nga struktura përkatëse e bashkisë Elbasan, e cila caktohet me urdhër të veçantë të Kryetarit të Bashkisë.
7. Aplikimi i sistemit të pagesës së parkimit të kryhet me punonjës shërbimi, të cilët do të pajisin në terren drejtuesin e mjetit me biletë/kupon parkimi, ku shënohet vlera në lekë dhe koha e qëndrimit.





- 8. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë për miratimin e formatit të biletës/kuptonit të shërbimit të parkimit, të cilët do të kenë elementë sigurie, logo dhe shenja të tjera dalluese.
- 9. Ngarkohet me ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit të Territorit Urban, Sektori i Transportit, Policia Bashkiake dhe Drejtoria e Finacës në Bashkinë Elbasan.
- 10. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij.

ANEKSI 1

**Rruget e sheshet publike ne te cilat do te ofrohet sherbimi i parkimit me pagese.**

Rruget	Te sugjeruara per parkim me pagese
1.Rruga (Bulevardi "Aqif Pasha")	Segmenti nga Stadjumi deri te Ura e Zaranikes, ne drejtim te perendimit ne krahun e majte
2.Rruga "Qemal Stafa"	Segmenti nga Kryq.RR,Q.Stafa me rrugen K.Sejdini deri Muzeu etnog. ne drejtim te perendimit ne krahu djathte.
	Segmenti nga Drejtoria e Tatimeve deri te rreth rrotullimi postes, dy krahet.
3.Rruga "Thoma Kalefi"	Segmenti nga rreth rrotullimi I Bashkise deri te Unaza ne dy krahet.
4. Rruga "Janaq Kilica"	Segmenti nga Nje maji deri te lulishtja para bashkise ne drejtim te jugut krahu i majte.( Para hamamit)
5.Rruga "Kozma Naska"	Segmenti prej Paralel me lulishten deri te kryqezimi me rrugen Aqif Pasha.
6.Rruga "28 Nentori"	Segmenti nga kryqezimi rruges Muc Shqiptari, para policise me rrugen 28 nentori deri te rreth rotullimi spitalit, ne drejtim te veriut, krahu i majte.
7.Rruga "25 Nentori" (e Treni)	Ne dy krahet
8.Rruga "Rinia"	Segmenti nga Universiteti Aleksandder Xhuvani deri te kryqezimi me rrugen Aqif Pasha, ne drejtim te jugut ne krahun e majte.
<b>Sheshet</b>	
1.Zona Sheshi prapa pallatit sportit	Pallati e Sportit, pjesa qendres, prapa pallatit.
2.Zona Hoteli "Skampa"	Pjesa e perparme e Hotel Skampes
3.Zona te "Kinemaja vullnetari"	Shesh I vogel ne te per pak mjete

11

Koha e funksionimit të parkimit me pagesë do të jetë:

<b>Zona e vendparkimeve me pagesë</b>	<b>Orari i funksionimit Dite jave (Hene Prente)</b>	<b>Të Shtunën</b>
1.Rruga Aqif Pasha	08:00 – 20:00	08:00 – 14:00
2.Rruga Qemal Stafa	08:00 – 16:00	08:00 – 14:00
3.Rruga Thoma Kalefi	08:00 – 16:00	08:00 – 14:00
4. Rruga "Janaq Kilica"	08:00 – 16:00	08:00 – 14:00
5.Rruga "Kozma Naska"	08:00 – 16:00	08:00 – 14:00
6.Rruga "28 Nentori"	08:00 – 16:00	08:00 – 14:00
7.Rruga 25 nentori (e Trenit)	08:00 – 16:00	08:00 – 14:00
8.Rruga Rinia	08:00 – 16:00	08:00 – 14:00
4 Sheshet	08:00 – 16:00	08:00 – 14:00

E Diela do të jetë pa pagesë

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin !

**SEKRETAR**  
**Klajd Gripshi**



**KRYETARI**  
**Hektor Ciftja**





796  
18.06.2020



6

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2766 Prot.

Elbasan, më 18/06/2020

VENDIM

Nr 61, datë 18.06.2020

**“Për një ndryshim dhe shtesë në VKB nr.180, datë 04.12.2019 'Mbi miratimin e numrit maksimal të punonjësve të Bashkisë dhe institucioneve vartëse të saj, si dhe miratimin e nivelit të pagave për vitin 2020”.**

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës 18.06/2020, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria Administratës dhe Burimeve Njerëzore e Bashkisë për një ndryshim në VKB nr.18, datë 11.02.2020 ""Mbi bashkimin e ndërmarrjes së terreneve sportive me klubin shkumësportësh Elbasan dhe rishikimin e numrit të punonjësve të Agjensisë së Shërbimeve Publike", me propozim të Kryetarit të Bashkisë, bazuar në ligjin 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” nenet 8, 9, 54 të tij, ligjin 68/2017 “Për financat e vetqeverisjes vendore” neni 40;

Vendosi

- 1- Bashkimin dhe unifikimin e tabelës së pagave në lidhjen nr.4 "Niveli i pagave për Klubin Shumësportësh" (Pas bashkimit të Ndërmarrjes së Mirëmbajtjes së Terreneve Sportive dhe Klubit Shumësportësh), për pasojë lidhja nr.8 "Niveli i pagave për Ndërmarrjen e Mirëmbajtjes së Terreneve Sportive" në VKB nr.180, datë 04.12.2019 shfuqizohet.
- 2- Në lidhjen nr.6 "Niveli i pagave për Qendën e Trashëgimisë Kulturore" përsa i përket kategorisë së pagës së Drejtorit të Qendrës së Trashëgimisë Kulturore nga II B në II A.



Lidhja nr.4

Niveli i pagave për Klubin Shumësportësh

NR.	Emërtimi	Kategoria/Klasa	Paga grupit	Vjetërsia në %	Shtesa për pozicion
<b>I</b>	<b><i>Punonjës të sistemit me pagë grupi + shtesë pozicioni</i></b>				
1	Drejtor	II B	1	2%	77 000
2	Përgjegjës	III A/1	1	2%	35 000
3	Specialist finance	IV A	1 ose 2 ose 3	2%	35 000
4	Specialist	IV A	1 ose 2 ose 3	2%	30 000
5	Instruktor/ Inspektor	IV A	1 ose 2 ose 3	2%	30 000
6	Koordinator i shoqatave sportive	IV A	1 ose 2 ose 3	2%	30 000
7	Arkëtar	IV A	1 ose 2 ose 3	2%	30 000
8	Magaznier	IV A	1 ose 2 ose 3	2%	30 000
9	Infermier, <i>Fizioterapist</i>	IV A	1 ose 2 ose 3	2%	30 000
<b>II</b>	<b><i>Punonjës të sistemit me klasa</i></b>	<b>Klasa</b>		<b>Shtesa për vjetërsi</b>	<b>Paga bazë</b>
1	Përgjegjës sektori/ Kryetar dege ne arsimin parauniversitar	XI		1%	37 000
2	Magaznier	V		1%	34 100
3	Ndihmës Specialist	VI		1%	34 500
4	Punëtor mirëmbajtje	IV		1%	33 400
5	Shofer me mjet mbi 2.5 ton	VIII		1%	35 400



Niveli i pagave per Qendren e Trashegimise Kulturore

Lidhja Nr.6

NR.	Emeritimi	Kategoria/Klasa	Paga grupit	Vjetesia ne %	Shtesa per pozicion
<b>I</b>					
<i>Punonjes te sistemit me pagw grupi + shtese pozicioni</i>					
1	Drejtor I Qendres se Trashgimise Kulturore	II A	1	2%	77 000
2	Drejtor I Bibliotekes	II B	1	2%	61 000
3	Drejtor I Muzeut	II B	1	2%	61 000
4	Perjegjies Finance	III A/1	1	2%	50 000
5	Bibliotekare	IV A	1 ose 2 ose 3	2%	30 000
6	Klasifikatore'	IV A	1 ose 2 ose 3	2%	32 000
7	Specialiste	III B	1 ose 2 ose 3	2%	42 000
<b>II</b>					
<i>Punonjes te sistemit me klasa</i>					
1	Dizenjator/ Magazinier	VII		1%	35 000
2	Bibliotekare	VIII		1%	34 000
3	Libralidhese	IV		1%	32 000
4	Pastruese	I		1%	30 000

1. Shtesa për vjetërsi në punë për Lidhjen Nr.6 per kategorinë I, të jepet në masën 2% pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe të llogaritet mbi pagën e grupit.

2. Shtesa për vjetërsi në punë për Lidhjen Nr.6 per kategorinë II, të jepet në masën 1% pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe të llogaritet mbi pagën bazë të klasës së lartë.  
Paga baze e klasës së I është 30 000 lekë



*[Handwritten signature in blue ink]*

3

- 3- Ngarkohen Kryetari, Drejtoria Administratës dhe Burimeve Njerëzore, si dhe Klubi Shumësportësh për zbatimin e këtij vendimi.
- 4- Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**SEKRETARI**

**Klajd GRIPSHI**

**KRYETAR**

**Hektor Çiftja**







REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2719/ Prot.

Elbasan, më 18.06.2020

V E N D I M

Nr. 62 Datë: 18.06.2020

“ Mbi dhënie me qira (rinovim kontrate) të një ambjenti “bodrum”

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës \_\_.06.2020 pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria Përgjithshme e Planifikimit të të Ardhurave Aseteve Buxhetit dhe Financës (sektori i pronave), bazuar në ligjin Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, VKM Nr. 416 datë 11.07.2007 “Për miratimin e listës përfundimtare të Pronave të Paluajtëshme të Shtetit që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Elbasan”, VKM Nr. 54 datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurive shtetërore”, Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr. 24 datë 24.02.2009 “Mbi miratimin e tarifave të dhënies së ambjenteve me qira nga Bashkia Elbasan”,

V E N D O S I:

1. Miraton dhënie me qira (rinovim kontrate) të ambjentit (bodrum) ndodhur nën pallatin Nr. 75, Lagja “Luigj Gurakuqi”, me sipërfaqe 38 m<sup>2</sup>, me tarifë qiraje 200 lekë/m<sup>2</sup>, afat 1 (një) vit subjektit (16.06.2020 deri më 15.06.2021) qiramarrës Znj. Eva Bajraktari për t’a përdorur për magazinë.
2. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Përgjithshme e Planifikimit të të Ardhurave Aseteve Buxhetit dhe Financës (sektori i pronave), dhe Drejtoritë e Buxhetit dhe Financës.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI  
Klajd Gripshi

KRYETARI  
Hektor Çiftja





788  
19.06.2020



2

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2720/11 Prot.

Elbasan, më 18.06.2020.

V E N D I M

Nr. 63 Datë: 18.06.2020.

"Për dhënien me qira të pasurisë Nr.1, Z.K 2355, ndodhur në Nj.A.Labinot –Fushë"

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës \_\_.06.2020 pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Administrata e Bashkisë bazuar në ligjin Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; ligjin Nr. 115/2014 "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; V.K.M Nr. 510 datë 10.6.2015 "Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial"; V.K.M Nr. 344 datë 29.04.2020 "Për Kalimin në Pronësi të Bashkisë Elbasan, për Njësine Administrative Labinot-Fushë, të Sipërfaqes prej 18493 m<sup>2</sup> e Llojit e Pafrytshme me Vendodhje në Zonën Kadastrale 2355"; V.K.M Nr. 54 datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurive shtetërore", i ndryshuar; Udhëzimin Nr. 13 datë 26.04.2018, "Për zbatimin e VKM-së Nr. 54, datë 05.02.2014...";

V E N D O S I :

1. Miraton dhënien me qira të pasurisë nr. 1, me sipëfaqe 18493 m<sup>2</sup>, ndodhur në Z.K. 2355, Nj. Administrative Labinot-Fushë, Elbasan, sipas procedurave ligjore të përcaktuara në V.K.M Nr 54, datë 05.02.2014 dhe Udhëzimin Nr. 13 datë 26.04.2018.
2. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administrata dhe Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI  
Klajd Gripshi



KRYETARI  
Hektor Çiftja





799  
18.06.2020



3

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN  
Këshilli Bashkiak

Nr. 2785/ Prot.

Elbasan, më 18.06.2020

Vendim  
Nr. 64 Datë 18/06/2020  
Për dhënje të drejtë përdorimi

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës \_\_\_/\_\_\_/2020, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga administrata e Bashkisë, për dhënjen e të drejtës së përdoeimit të infrastrukturës së Bashkisë për kalimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë, bazuar në ligjin 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” nenet, 8, 9, 23, 28 e 54 të tij, ligjin 120/2016 “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e të drejtës së kalimit”, ligjin 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndyshuar,

Vendosi

- 1- Të miratojë ne parim kërkesën e subjektit “Best Cable” sh.p.k., për përdorimin e infrastrukturës së Bashkisë për kalimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë, sipas përcaktimeve që do të bëhen nga Drejtoria e Urbanistikës dhe Zhvillimit të Territorit.
- 2- Subjekti kërkues, të paraqesë projektin e detajuar i cili do të miratohet nga Bashkia
- 3- Pas marrjes së licensave dhe lejeve përkatëse nga subjekti kërkues dhe miratimit të projektit, marrdhënjet dhe detyrimet përkatëse në lidhje me serviturin e kalimit të rrjeteve, do të përcaktohen në një marrveshje midis kërkuesit dhe Bashkisë Elbasan.
- 4- Ngarkohen Kryetari dhe administrata e Bashkisë me zbatimin e këtij vendimi
- 5- Ky vendim hyjn në fuqi 10 ditë pas shpalljes

Sek. K. Bashkiak  
Klajdi Gripshi

Kryetari  
Hektor Çiftja

